



Një lider me këmbë në tokë: Angela Merkel e bën vetë pazarin
 Gratë e Kosovës duan drejtësi, jo lule
 Bashkimi European një hap më pranë kuotave të grave në bordet e firmave private

EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.8, Mars - Prill 2012

Speciale

A mund të shpëtojë Europa?



Karikatura: Pëll Hoxha

Reforma në drejtësi, prioritet kyç për integrimin në Bashkimin European

Prof. Luan Omari, një ndër konstitucionalistët më të spikatur analizon për EuroSpeak problemet aktuale të sistemit të drejtësisë si dhe hapat e nevojshëm për një reformë efektive

Reforma në drejtësi konsiderohet nga Komisioni European një prioritet kyç për tu adresuar në mënyrë që Shqipëria të marrë statusin e vendit kandidat dhe një datë për hapjen e negociatave. Bashkimi European pret konkretisht që Shqipëria të ndërmarrë hapa reformues që të garantojë pavarësinë, eficientën dhe përgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë. Ai ka vënë në dukje sistematikisht nevojën që këto reforma të jenë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Miratimi në korrik 2011 i Strategjisë për Reformën në Gjyqësor dhe Planit të Veprimit përbën një fillim të mirë në reformimin e drejtësisë. Megjithatë, siç theksohet

...vijon në faqen 2 >>

Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve. Një shans i ri për 2012?



Foto: worldbank.org

Ndërkohë që politikanët nuk humbasin rast të deklarojnë se integrimi në Bashkimin European është prioritet kombëtar, koha po ecën dhe BE po pret përmbushje konkrete të 12 prioritetëve kyçe të identifikuar nga Opinioni i Komisionit European mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim.

Në kontekstin rajonal, vendet fqinje po shënojnë hapa përpara drejt integritimit European. Mali i Zi fitoi statusin e vendit kandidat në vjeshtën e 2011 dhe pret fillimin e bisedimeve për anëtarësim këtë verë. Serbia, e cila e fitoi atë para pak ditësh, është gjithashtu e orientuar drejt fillimit të bisedimeve për anëtarësim. Kosova pret me padurim Raportin e Fizibilitetit.

Ndaj, viti 2012 duhet konsideruar vendimtar për Shqipërinë. Megjithë bashkëpunimin ndërmjet qeverisë dhe opozitës (përkatësisht Ministrisë së

...vijon në faqen 5 >>



Analizë e Alfred Gusenbauer, ish-Kryeministri i Austrisë 2007 - 2008

Në vitin 2011, kriza financiare dhe bankare u përshkallëzua në një krizë të sovranitetit dhe borxhit. Problemi nisi në Greqi dhe ngriti dyshime në lidhje me qëndrueshmërinë e euros dhe madje edhe vetë BE-së.

Por, nëse krahasojmë BE-në me Shtetet e Bashkuara ose Japoninë (ku borxhi publik është i barabartë me 200% të PBB-së), imazhi i varfër aktual i BE-së është i pajustificuar. Në tërësi punësimi në BE mbetet i lartë, ashtu sikurse edhe normat e kursimeve. Për më tepër, tregtia e BE-së është në ekuilibër me pjesën tjetër të botës. Një arsye dyshimi mbi qëndrueshmërinë e euros dhe BE-në lidhet me faktin se, që nga pranvera

...vijon në faqen 4 >>

Reforma në drejtësi, prioritet kyç për integrimin në Bashkimin European

...vijon nga faqja 1 >>

në Progres Raportin e KE-së për 2011, probleme të shumta e të ngulitura thellë në sistemin e drejtësisë shqiptare vazhdojnë të cenojnë garantimin e shtetit të së drejtës. Numri i çështjeve të akumuluar në pritje për tu shqyrtuar në gjykata dhe zgjatja e tepërt e procedurave kërcënojnë efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Buxheti për sistemin gjyqësor vazhdon të jetë i pamjaftueshëm. Për më tepër, asnjë hap nuk është ndërmarrë në luftimin e korrupsionit në sistemin gjyqësor. Përqindja e ekzekutimit të vendimeve vazhdon të mbetet e ulët. Ligje të rëndësishme që kërkojnë tre të pestat e votave në parlament, si ligji për gjykatat administrative, janë ende në pritje të miratimit.

EuroSpeak: Prof. Omari, prej vitesh flitet për nevojën e reformave në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, por pak apo aspak zhvillime të rëndësishme janë vërejtur. Përplasjet midis institucioneve kryesore të vendit dhe atyre të drejtësisë, procese të bujshme të cilat kanë dështuar, dalja në pah e boshllëqeve ligjore të cilat nuk mund të adresohen pjesërisht, kanë pasuruar listën e problemeve që duhen trajtuar. Sipas mendimit tuaj, nga duhet të fillojë reforma në drejtësi dhe cilat janë

Barazia para ligjit...



disa fusha më parësore në nevojë për ndërhyrje të menjëhershme?

Prof. Luan Omari: Reforma në drejtësi, që sot është një nevojë imperative, nuk duhet të përjashtojë reformën në Gjykatën Kushtetuese, pavarësisht se kjo gjykatë nuk është pjesë e sistemit gjyqësor. Kjo reformë nuk mund të kryhet pa ndryshime në Kushtetutë. Kushtetuta jonë parashikon masa efikase për të shmangur shkarkimin arbitrar nga Kuvendi të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ashtu edhe të Gjykatës së Lartë. Ky shkarkim mund të bëhet për arsye të forta dhe me votat e shumicës së dy të tretave të të gjithë deputetëve dhe madje në të dy rastet, vendimi i Kuvendit i nënshtrohet shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese. Por paradoksalisht, kur është fjala për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë nga Presidenti i Republikës, pëlqimi nga Kuvendi jepet me një shumicë të thjeshtë, pra edhe me 36 vota, me kusht që në

Dëftesa e Progresit të Shqipërisë Drejt Anëtarësimit në Bashkimin European: Gjyqësori*

Sipas Vlerësimeve të Progres Raportit të Komisionit European

| Çështjet | Raporti Analitik i Komisionit European 2010 | Progres Raporti i Komisionit European 2011 | Nota |
|---|---|---|------|
| <i>Demokracia dhe shteti i së drejtës</i> | | | |
| Gjyqësori | Në tërësi, Shqipërisë i mungon tradita e pavarësisë së gjyqësorit. Vendi duhet të vazhdojë procesin e reformimit të gjyqësorit, përfshi miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të reformës në gjyqësor dhe të ligjeve kyçe që kanë ngelur pezull, si edhe krijimin e një historiku rezultatesh solide në zbatimin e ligjit. | Progres i kufizuar me reformën në drejtësi. Strategjia për reformën në sistemin e drejtësisë dhe plani i veprimit është miratuar dhe zbatimi sapo ka filluar. | D |

* Për të dhëna mbi fushat e tjera, mund të konsultoni Dëftesën e plotë tek www.em-al.org

votim të marrin pjesë 71 deputetë. Ekziston pra mundësia, sidomos kur Presidenti i Republikës zgjidhet me votat e maxhorancës qeverisëse, që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë të caktohen pa marrë fare parasysh vërejtjet e deputetëve të opozitës. Prandaj do të ishte e dobishme dhe do të garantonte një përbërje më të ekuilibruar të të dy gjykatave, dhënia e pëlqimit nga Kuvendi me një shumicë të cilësuar prej tre të pestash për Gjykatën e Lartë ndërsa për Gjykatën Kushtetuese ndoshta do të duhej një shumicë prej dy të tretash, sipas shembujve të Gjermanisë dhe Hungarisë. Gjithashtu do të ishte e arsyeshme, që mandati i gjyqtarit kushtetues në çdo rast të ishte nëntë vjeçar, çka do të thotë që ai të mos ndërpritet edhe kur mbush moshën e pensionit.

Veç kësaj, do të duhet që në ligjet organike të Gjykatës së Lartë dhe veçanërisht të Gjykatës Kushtetuese, të shtjellohen kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve përkatës, për të siguruar një nivel sa më të lartë profesional të përbërjes së tyre. Këto masa i konsideroj të dobishme, madje të domosdoshme, duke pasur parasysh, veçanërisht rëndësinë e Gjykatës Kushtetuese, e cila në raport me Kuvendin ka kompetenca edhe më të mëdha se sa Presidenti i Republikës, i cili një ligj të miratuar nga ai organ mund ta kthejë për rishqyrtim (dhe kjo mund të kapërcehet me votën e shumicës së të gjithë deputetëve) kurse Gjykata Kushtetuese mund ta shfuqizojë përfundimisht një ligj.

Për një reformë në sistemin gjyqësor do të ishte e nevojshme që të përcaktoheshin kritere më të rrepta për ecjen në karrierë të gjyqtarëve, për të shmangur rastet (si edhe ka ndodhur) që gjyqtarë pa përvojën dhe përgatitjen e duhur profesionale, "të katapultohen" nga një gjykatë e një rrethi të vogël deri në Gjykatën e Lartë dhe për më

tepër, në Gjykatën Kushtetuese. Veç kësaj do të duhej një kontroll më rigoroz nga instancat më të larta gjyqësore si dhe KLD për të zbuluar dhe evidentuar rastet e korrupsionit aq të përfolur në radhët e gjyqtarëve.

EuroSpeak: Reforma në drejtësi përbën gjithashtu një prioritet kyç për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Në Planin e Veprimit për Adresimin e 12 Rekomandimeve të KE-së i cili është përditësuar nuk adresohen disa elementë me rëndësi të evidentuar nga Progres Raporti 2011 si miratimi i ligjeve organike (p.sh ligjit për Konferencën Gjyqësore, apo ndryshimi i ligjeve të tjera organike si: ligji për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ligji për Gjykatën e Lartë apo Gjykatën Kushtetuese, ligji për administratën gjyqësore). Nga lista e ligjeve organike është parashikuar vetëm ligji për gjykatën administrative. A mendoni se këto elementë të lënë jashtë mund të bëhen pengesë për reformimin e sistemit të drejtësisë?

Prof. Luan Omari: Mendoj se nuk mund të shmangët rishqyrtimi i këtyre ligjeve, duke nisur nga ai për KLD, që është ende në fuqi, pasi Gjykata Kushtetuese, me të drejtë shfuqizoi si antikushtetues një ligj të mëvonshëm, miratuar nga Kuvendi. Rishikimi dhe ndryshimi i ligjeve të tilla, duhet të bëhet jo vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë të shumicës me opozitën, i domosdoshëm për deri sa këto ligje miratohen me një shumicë prej tri të pestash, por edhe duke dëgjuar vërejtjet dhe sugjerimet e gjyqtarëve dhe prokurore të të gjithë hallkave si dhe të profesorit të drejtësisë.

Reforma në sistemin gjyqësor duhet të synojë jo vetëm një performancë më të mirë në dhënien e drejtësisë, por edhe forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, që shpesh është vënë në pikëpyetje nga ndërhyrjet politike të dy pushteteve të tjera, sidomos të atij ekzekutiv. Në këtë kuadër do të ishte mirë që kontrolli i gjykatave të bëhej vetëm nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që është organ i vetëqeverisjes së gjyqësorit, duke i lënë Ministrisë së Drejtësisë vetëm inspektimin ndaj administratës së gjykatave. Kjo do të ishte në përputhje me sugjerimet e bëra prej kohe edhe nga Komisioni i Venecias.

Nuk janë karnavalet...



Karikatura: Rael Hoxha



A mund të shpëtojë Europa?

...vijon nga faqja 1 >>

e 2010, liderët europianë kanë nxituar sa nga një samit në tjetrin dhe asnjëherë nuk kanë zhvilluar plotësisht potencialin e tyre ekonomik dhe politik për të ofruar zgjidhje.

Nuk duhet të na vijë si befasi nëse qeveritë kombëtare me provincializmin e tyre pengojnë veprimin e përbashkët të BE-së, apo që tregjet financiare po përdorin të njëjtën taktikë si komunistët për ta zvogëluar BE-në duke sulmuar vendet e saj anëtare një nga një. Në të vërtetë, Parlamenti dhe Komisioni European janë mënjanuar, ndërkohë që një model i ri i menaxhimit të Europës po shfaqet: Gjermania merr vendimet, Franca jep konferenca shtypi, dhe pjesa tjetër dremit (me përjashtim të britanikëve, të cilët kanë zgjedhur izolimin përsëri). Kjo strukturë menaxhimi nuk është as demokratikisht legjitime as e justifikuar nga performanca e saj.

Në të vërtetë, disa vlerësojnë se deri në vitin 2050 Europa do të prodhojë vetëm 10% të PBB-së në botë, dhe do të përbëjë vetëm 7% të popullsisë së saj. Europa po lufton për mbijetesën e saj ekonomike, por a kemi ndërmend ne europianët të forcojmë pozitën tonë në shekullin e njëzet e një? Apo jemi të përgatitur që t'i nënshtrohen një rënieje të dhimbshme shkaktuar nga grindjet nacionaliste dhe vetëkënaqësia? Unë mbroj një Europë të fortë që përfshin sfidat e një bote në ndryshim.

Ne kemi nevojë për një kontratë të re midis kombeve europiane, gjeneratave dhe klasave sociale, gjë e cila nënkupton zgjedhje të vështira. Ne duhet t'i japin lamtumirën egoizmit kombëtar, interesave vetjake, trukeve të pista, dhe sigurive të supozuara. Nëse Europa dëshiron që gjërat të mbeten ashtu si janë, atëherë gjërat do të duhet të ndryshojnë në mënyrë dramatike.

Së pari, BE-ja duhet të shndërrohet në një demokraci të vërtetë - me një president të zgjedhur direkt nga qytetarët europianë dhe një parlament të fortë. Pakti fiskal për të cilin anëtarët e BE-së (me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës Çeke) ranë dakord në dhjetor të vitit 2011, nuk mund të lihet vetëm në duart e

burokratëve dhe gjykatave. Populli europian, sovranët e vërtetë, në fund të fundit duhet të fitojnë të drejtën për të bërë zgjedhjen e politikave europiane nëpërmjet zgjedhjeve.

Së dyti, ne duhet të zvogëlojmë hendekun e të ardhurave. Ndarja në rritje midis klasës së të pasurve dhe të varfërve, stanjacioni i pagave dhe pabarazitë e thella rajonale të papunësisë janë të dyja moralisht të papranueshme dhe ekonomikisht joproduktive. Pabarazia në rritje e të ardhurave në nivel BE-je nuk realizon shpërndarjen e fuqisë blerëse duke mos sjellë rritje dhe punësim për të cilën ekonomia e saj ka dëshpërimisht nevojë.

Së fundi, shteti social ka nevojë për një rishikim serioz. Sot, BE-ja cakton një pjesë të madhe të shpenzimeve të saj publike për pensionet dhe kujdesin shëndetësor për të moshuarit, ndërsa arsimit vuan nga mungesa e financimit. Një shtet i mirëqenies që fokusohet kryesisht tek të moshuarit, dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme për brezat e rinj, nuk është i qëndrueshëm. Për më tepër, pabarazitë e krijuara nga privilegje të tilla si skemat e pensionit në sektorin publik dhe avantazhet e vogla për grupe të caktuara interesi, duhet të adresohen.

Në mënyrë që këto ndryshime të realizohen, rritja e taksave mbi pasurinë dhe të ardhurat është pashmangshme. Por, ndërsa këto të ardhura shtesë nga taksat do të përmirësonin financat publike të Europës, ato nuk do të shmangnin nevojën për të reformuar shtetin e mirëqenies.

Është gjithashtu një gabim besimi se masat e kursimit - fokusi kryesor i liderëve të Europës deri tani, do të konsolidojnë financat publike. Europa është në prag të recesionit, prandaj qeveritë duhet të kufizojnë shkurtimet e shpenzimeve nëse nuk duan që ekonomia të kontraktohet.

Gjithashtu, ata duhet të rrisin vetëm ato taksa që nuk do të shkaktojnë reduktimin e konsumit, investimeve, ose krijimin e vendeve të punës. Përveçkësaj, një "Plan Marshall European" që ofron investime në infrastrukturë, energjinë ripërtëritëse

dhe eficientë në përdorimin e saj është i nevojshëm. Një nismë e tillë jo vetëm që do të nxisë rritjen, por gjithashtu do të ulë deficitin aktual. Financat publike do të konsolidohen vetëm nga rritja dhe jo nga kursimi. Banka Qendrore Europiane duhet të përshtatet me rregullat e reja të paktit fiskal. Dobësia e qeverive kombëtare në tregjet financiare dhe normat e ekzagjeruara të interesit duhet të reduktohen.

Vetëm Banka Qendrore Europiane, duke marrë rolin e huadhënësit të instancës së fundit, mund të ndalojë shkatërrimin e eurozonës dhe të rivendosë besimin në kapacitetin e Europës për të zgjidhur problemet e veta. Europa po humbet kohë. Institucionet e BE-së duhet të ushtrojnë krijimtari në tyre të plotë - të menduarit konvencional nuk do të jetë i mjaftueshëm për të ruajtur BE-në. Vetëm kur BE-ja të këtë kokën mbi ujë sërish, atëherë ajo mund të hyjë në rrugën e vështirë por të nevojshme të inkuadrimit dhe miratimit të një traktati të ri për një Europë të re.

Project Syndicate, mars 2012

Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve. Një shans i ri për 2012?

...vijon nga faqja 1 >>>

Integritet Europian dhe Komisionit parlamentar të Integritet Europian) në përgatitjen e Planit të Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve dhe mbështetjen intensive të BE-së për këtë proces, rrugëtimi europian i Shqipërisë ende nuk ka dalë plotësisht nga apatia.

Konkretisht, detyra e Shqipërisë menjëherë pas publikimit të Progres Raportit më 12 tetor 2011 ishte të përditësonte Planin e Veprimit sipas sugjerimeve të Komisionit Europian, çka përfshinte ndër të tjera dhe miratimin e tij në parlament (për shembull nëpërmjet një rezolute të aprovuar nga të gjitha palët) si dhe zbatimin efikas.

Ministria e Integritet Europian fillimisht përcaktoi një axhendë ambicioze për përditësimin e Planit të Veprimit për 12 prioritetet. Gjithashtu detyrat u ndanë mes saj dhe Komisionit të Integritet Europian

të Kuvendit, i cili mori përsipër koordinimin e procesit të përditësimit për rekomandimet 1-4. Edhe pse procesi i përditësimit nisi me ritmin e duhur dhe me një axhendë ambicioze, nuk mund të thuhet se ai ka marrë vëmendjen e duhur nga politika.

Përfshirja më e drejtpërdrejtë e Kuvendit shënon një hap përpara në krahasim me vitin kaluar ku Ministria e Integritet Europian ishte aktori ekskluziv i menaxhimit të këtij procesi. Një hap pozitiv përbën dhe praktika e seminarit të BE-së me palët e interesuara të mbajtur sërish si dhe konsultimet e ndryshme të Komisionit të Integritet Europian dhe Ministrisë së Integritet Europian, me grupet e interesit, duke realizuar kështu një proces më të hapur të përditësimit të Planit të Veprimit.

Plani i Veprimit u miratua nga Komiteti Ndërmintor për Integritet më 21 mars, dhe iu dorëzua shërbimeve të Komisionit Europian. Plani i Veprimit mund të shërbejë si një bazë për fillimin e një pune të gjithanshme për përmbushjen e 12 prioritetëve. Ndërkohë që Shqipëria do të vlerësohet mbi bazën e përmbushjes së 12 prioritetëve të identifikuar, në mënyrë që të avancojë në procesin e kandidimit.

Me gjithë miratimin e një sërë ligjesh të rëndësishme, prej vitesh të bllokuara, duket se ende nuk është përmbushur plotësisht asnjë nga 12 prioritetet e përcaktuara në vitin 2010. Shumë pak kohë për të dëshmuar progres na ndajnë nga fillimi i shtatorit, muaj në të cilin Komisioni mbledh përfundimisht të dhënat kryesore për hartimin e Progres Raportit për vitin 2012.

Është koha që angazhimet të përkthehen në rezultate të prekshme gjatë këtij 6 mujori që Shqipëria të mund të marrë statusin e vendit kandidat brenda vitit 2012. Pasi përvojat e hidhura të viteve elektorale - sikurse është 2013 – tregojnë për një vëmendje edhe më të vogël ndaj kursit të reformave, aq shumë të nevojshme për procesin e integritet europian të Shqipërisë.

Stafi i EuroSpeak, mars 2012

Kartolina nga BE-ja

Skocia drejt mbajtjes së një referendumi për pavarësinë



Foto: bbc.co.uk

Në Skoci, Partia Kombëtare fitoi befasisht kontrollin e Parlamentit rajonal vitin e kaluar, çka ushqeui fantazitë separatiste. Qeveria britanike, e vënë në një cep të pasigurt, ka hapur tashmë negociatat formale me skocezët për të vendosur një datë për referendum mbi pavarësinë.

Skocia fitoi të drejtën e një Parlamenti të vetin në fund të viteve 1990 dhe ka pushtet të plotë mbi sistemin e saj gjyqësor dhe shpenzimet e qeverisë. Por pavarësia e plotë do t'i jepte partisë më të fortë autoritetin për të përmbushur një sërë dëshirash të mbetura peng, përfshirë këtu dëbimin e flotës bërthamore britanike nga ujërat skoceze, tërheqjen nga NATO-ja dhe largimin e regjimenteve skoceze nga forcat ushtarake të Britanisë jashtë vendit. Ajo gjithashtu do t'i jepte politikanëve në Edinburg lirinë për të votuar veçmas nga - dhe ndoshta në kundërshtim me - Britaninë në organizatat botërore si Kombet e Bashkuara dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Si në çdo divorc, ndarja nga Britania do të shkaktonte gjithashtu konfrontime të natyrës ekonomike, veçanërisht mbi të drejtat e nxjerrjes së naftës në Detin e Veriut, një element kyç për prosperitetin e skocezëve.

Nisma për një referendum për pavarësi në Skoci po ndiqet me nervozizëm në Europë, veçanërisht në vendet që kanë luftuar gjatë me lëvizje të fuqishme separatiste si Spanja dhe Belgjika. Në të njëjtën kohë, perspektiva e një Skocie të pavarur ka shkaktuar tronditje në Londër. Nga frika e humbjes së zërit të Britanisë moderne në çështjet globale dhe e një shpërbërjeje të pariparueshme e Britanisë moderne, këtë muaj kryeministri David Cameron filloi betejën e tij për të fituar zemrat dhe mendjet e skocezëve. "Unë besoj se Anglia, Skocia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut janë më të forta së bashku nga ç'do të ishin të ndara. Diçka shumë e veçantë është në rrezik. Rreziku vjen nga vendosmëria e Partisë Kombëtare Skoceze për të hequr Skocinë nga shtëpia jonë e përbashkët" – u shpreh Cameron.

The Washington Post, 26 shkurt 2012

Slovakia shikon majtas

Robert Fico është bërë brenda natës një nga politikanët e majtë më të suksesshëm të Europës. Në zgjedhjet parlamentare të 10 marsit në Sllovaki, Partia Social-demokratike fitoi 45 % të votave, duke marrë 83 vende në asamblenë 150-anëtarëshe. Kjo është hera e parë që një parti e vetme ka marrë një shumicë parlamentare në historinë e Sllovakisë post-komuniste. Robert Fico ka drejtuar më parë qeverinë sllovaqe në periudhën 2006 – 2010, kohë kur vendi u anëtarësua në BE (viti 2007). Në atë kohë, ashtu si edhe në kabinetin e ri, roli i Ministrit të Jashtëm është mbuluar nga Miroslav Lajcak, i dërguari i Bashkimit Europian për të nxitur zgjidhjen e ngërçit politik në Shqipëri pas zgjedhjeve të 2009-ës.

Qeveria e Z.Fico zëvendësoi koalicionin e qendrës së djathtë prej katër partish që mori detyrën më pak se dy vjet më parë. Suksesi i tij reflekton pjesërisht zemërimin



Foto: thestar.com

publik ndaj akuzave për korrupsion të lindura që në dhjetorin e kaluar sipas të cilave disa funksionarë politik të lartë të qendrës së djathtë merrnin pagesa të paligjshme në shkëmbim të kontratave publike dhe marrëveshjeve të privatizimit. Ish-qeveria e qendrës së djathtë, e cila kishte shkëlqyer më parë në Bruksel dhe Uashington për reformat e saj të guximshme, pësoi një humbje drastike.

Stafi i EuroSpeak, 13 mars 2012

Italian job!

Që kur mori detyrën nëntorin e kaluar, Kryeministri i Italisë, Mario Monti, është përshëndetur si një yll i ri në skenën evropiane. E folura elokumente dhe sjellja e butë e ka lejuar atë që të ndërtojë profilin e një ndërmjetësi të besueshëm në eurozonën konfliktuale. Paketa e tij me masa të ashpra kursimi, ka rivendosur rregullin në financat e Romës. Falë këtyre masave dhe likuiditetit të ofruar nga Banka Qendrore



Foto: ilpost.it

Europiane, presioni ndaj Italisë është zbutur. Kostoja e detyrimeve dhjetë-vjeçare ka rënë me rreth një të tretën që kur ai mori detyrën. Me gjithë apli-

kimin e “ilaçeve” të forta, Z. Monti mbetet popullor: mbështetja nga publiku është ende mbi 50 %.

Por Monti ka ende shumë pengesa për të kapërcyer. Sfida kryesore qëndron tek ri-ndezja e rritjes ekonomike të Italisë, e cila ka qenë pothuajse në stanjacion për pjesën më të madhe të dekadës së fundit. Që kjo të ndodhë, Italia duhet të reformojë tregun e saj dy-shtresor të punës. Në një anë të spektrit, janë punëtorët e moshuar, të cilët gëzojnë kontrata të përhershme dhe shumë të sigurta, ndërsa në anën tjetër, ka disa miliona punëtorë në pozicione të përkohshme. Jo vetëm që kjo strukturë është e padrejtë, por gjithashtu tepër joefikase. Punëdhënësit janë shpesh të detyruar të mbajnë punëtorët më pak produktivë, sepse nuk mund të ofrojnë kontrata të përhershme për të punësuar të rinj, më të talentuar.

Kjo ka pasoja të rënda për ekonominë. Të frustruar nga vështirësia për ndërtimin e një karriere, shumë italianë të rinj çdo vit zgjedhin të largohen. Ata që qëndrojnë, marrin trajnime të pakta për shkak të natyrës së përkohshme të punës së tyre. Z. Monti duhet të marrë masa të ashpra kundrejt abuzimit me kontratat e përkohshme nga firmat, por njëkohësisht duke e bërë më të lehtë për to të pushojnë nga puna punonjësit. Si koncesion ndaj sindikatave, ai duhet të premtojë që do të zgjerojë rritjen sociale të sigurisë, aktualisht e pamjaftueshme për nevojat.

Këto reforma nuk janë të lehta por Kryeministri nuk e ka opsionin për tu treguar i ndrojtur. Investitorët, por dhe te rinjtë, po ndjekin nga afër reformën e tregut të punës. Z. Monti ka një mundësi unike për të çrrënjësuar një nga shkaqet më të thella të performancës së dobët të Italisë. Ai nuk duhet ta shpërdorjë atë.

Financial Times, 13 mars 2012

Reformimi i Schengenit me themel, një sipërmarrje e vështirë



Foto: dw.de

Komisionerja Europiane për Çështjet e Brendshme, Cecilia Malmström, ka paralajmëruar se një reformë themelore e zonës Schengen siç pretendohet nga presiden-

ti francez kërkon reformimin e Traktatit të BE-së, diçka e komplikuar për nga vetë natyra e tij. Përpara pak kohësh, Presidenti Francez kërkoi një rishikim të marrëveshjes Schengen në mënyrë që “të jetë në gjendje të dënojë, të pezullojë ose të përjashtojë një shtet Schengen që dështon, siç mund të ndodhë me penalizimin e një shteti në zonën euro i cili nuk i përmbush detyrimet.” Ai paralajmëroi se vendi i tij do të pezullojë pjesëmarrjen në Marrëveshjen e Schengenit nëse kjo kërkesë nuk bëhet realitet brenda dymbëdhjetë muajsh.

Ndërkohë, disa nga kërkesat e Nicolas Sarkozy adresohen tashmë nga një projekt rishikimi i Marrëveshjes Schengen që po zhvillohet në Bruksel. Projekti synon t’u mundësojë vendeve që përballen me një fluks masiv dhe të pakontrolluar emigrantësh të paligjshëm të drejtën të rivendosin përkohësisht kontrollet kufitare. Por, nëse Franca kërkon futjen e mundësisë së dëbimit të plotë të një shteti, kjo gjë duhet të kalojë nëpërmjet rishikimit të Traktatit duke u dashur kështu pëlqimi i të gjithëve. Komisionerja Malmström ka insistuar se përmirësimi i Schengenit është tashmë në diskutim brenda BE-së. “Ne po negociojmë” me kërkesë të qeverive të vendeve anëtare, të cilat synojnë forcimin e sistemit të vlerësimit “të kontroleve kufitare me vendet e zonës Schengen”, si dhe të “forcojnë besimin në zonë dhe për të siguruar lëvizjen e lirë”, tha Komisionerja.

Ministrat e Brendshëm të BE-së mbajtën një takim mbi këtë temë në fillim të marsit në Bruksel. Ministri i Brendshëm francez, Claude Gueant, nuk mori pjesë. Në të u diskutua pikërisht mbi futjen e mekanizmave më të rrepta të monitorimit për vende që ballafaqohen me vështirësi në ruajtjen e kufijve të jashtëm të zonës Schengen.

Libération, 12 mars 2012

Një lider me këmbë në tokë: Angela Merkel e bën vetë pazarin



Foto: elmundo.es

Kancelaria gjermane, Angela Merkel pasi nënshkroi në Bruksel paktin fiskal është fotografuar po atë ditë në një supermarket në Berlin duke bërë pazar. Këto imazhe janë publikuar në një prej gazetave të më famshme gjermane, Bild Zeitung. Për çdo grua që punon, bërja e pazarit pas pune është pjesë e rutinës. Nëse pyet ndonjë kryetar qeverie se sa kushton një bukë me siguri ai nuk e di. Ndoshta kjo për shkak se politikanët janë larguar gjithnjë e më shumë nga realiteti dhe jetesa e përditshme, por edhe për shkak se kreu i qeverisë në fjalë është një burrë. Nëse një pyetje e tillë do t'i ishte drejtuar Znj. Merkel me siguri do të kishte ndodhur krejt e kundërta.

Është pikërisht kjo lidhja me realitetin e përditshëm gjerman, për të cilën elektorati falënderon Merkelin. Edhe pse gjermanët janë më së shumti (62%) kundër paketës së shpëtimit, kancelarja përçon në publik imazhin e dikujt që mund t'i besohet menaxhimi i të mirave publike. Sipas një sondazhi të bërë nga revista 'Stern', Merkel gëzon aktualisht nivelin më të lartë të popullaritetit të saj gati 64% që prej rizgjedhjes në vitin 2009. Për të ndryshuar qeverinë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, në qoftë se sondazhet nuk do të ndryshojnë, do të kërkohet një koalicion mes Social Demokratëve dhe të Gjellbërve.

El Mundo, mars 2012

A ka dështuar multikulturalizmi në Europë?

Në prag të zgjedhjeve, Presidenti Francez në një debat televiziv ka mbrojtur premtimin e dhënë gjatë fushatës elektorale për të përgjysmuar numrin e emigrantëve të rinj që vijnë në Francë. Mesazhi i tij mund të mbështetet nga votuesit e djathtë që besojnë se vendi është duke u përmbatur nga të huajt, por a është i saktë pohimi i tij se sistemi për të integruar emigrantët po dështon?

Organizata e Kombeve të Bashkuara deklaron se migracioni në Europë është në rritje. Europa është shtëpia e më shumë se 730 milion njerëzve ndër të cilët 9.5% e tyre janë emigrantë. Megjithatë, deklarata e Sarkozisë, nuk është një pretendim i ri, pasi një numër në rritje liderësh europianë i kanë bërë jehonë kësaj ndjenje. Në shkurtin e vitit të kaluar, Kryeministri Britanik, David Cameron tha se doktrina e shtetit multikultural kishte inkurajuar ndarjen duke pohuar se: "Ne kemi inkurajuar kulturat e ndryshme të jetojnë të ndara veç e veç nga njëra-tjetra. Ne kemi dështuar në sigurimin e një vizioni të shoqërisë në të cilën emigrantët mendojnë se duan të përkasin." Ai vazhdoi duke thënë: "Ne madje i kemi toleruar këto komunitete të ndara të sillen në një mënyrë që bie ndesh me vlerat tona."



Foto: balticreview.com

Angela Merkel, kancelaria gjermane ka pranuar se shoqëria multikulturore kishte dështuar. Gjatë një fjalimi ajo theksoi: "Le të pranojmë konceptin multikulturor dhe të jetojmë në lumturi krahas për krahas me njëri-tjetrin. Por ky koncept ka dështuar, dhe ka dështuar krejtësisht."

Pse liderët europianë gjithnjë e më shumë po pohojnë se multikulturalizmi është një gabim? Dhe cilat janë alternativat për një kontinent të ndryshëm?

Aljazeera, mars 2012



Në pritje të aderimit...

Komunikimi i dështuar i "Komitetit Qendror" të BE-së

Dilemat aktuale që BE-ja ka për politikën e saj të zgjerimit janë ilustruar mjaft mirë në përpjekjet e dëshpëruara për të tërhequr vëmendjen e audiencës rinore. Nga njëra anë BE-ja promovon diversitetin me çdo cent që ajo shpenzon në qindra fushata, dhe nga ana tjetër, kur diversiteti është prezent dhe dallimet janë të dukshme, ata promovojnë ngjashmëritë. Ku qëndron problemi nëse Ballkani është ndryshe nga Europa Qendrore, e cila është ndryshe nga Skandinavia, e cila është ndryshe nga Europa e Mesdheut, etj.? Një reklamë e publikuar së fundmi duket se hamendëson se nuk ka vlerë në vetvete për të qenë një shtet apo shoqëri Ballkanike. "Bëni mirë të dukeni si ata që ju frymëzojnë".

Kjo nuk është asgjë tjetër por një shprehje e mungesës së thellë të ideve e koncepteve, për t'i shitur qytetarëve të BE-së idenë se Ballkani i përket BE-së, si dhe qytetarëve të Ballkanit idenë se diversiteti është në fakt nuk është një difekt në vetvete. Objekt kritikash ishte edhe një video tjetër "EU enlacement ad" e postuar në të njëjtin kanal, e cila më vonë u hoq nga interneti. Ky është përshkrimi zyrtar i përmbajtjes: "klipi paraqiti karaktere tipike për stilin e arteve marciale: kung fu, capoeira dhe mjeshtrove kalaripayattu. Videoja fillon me një demonstrim të aftësive të tyre dhe përfundon me të gjithë personazhet që tregojnë respektin e tyre të ndërsjellë, duke përfunduar në një pozicion të paqes dhe harmonisë. Stili u zgjodh për të tërhequr të rinjtë dhe për të ngritur kureshtjen e tyre në një politikë të rëndësishme të BE-së."

A është vërtetë ky niveli intelektual që ju i atribuoni europianëve të rinj, të cilët shikojnë kanalën e BE-së në YouTube? Apo është niveli që ju i atribuoni brezit të ri të shteteve që aspirojnë anëtarësimin? A janë ata me të vërtetë kaq të cekët për t'i blerë këto historira? Natyra femërore e historisë dhe mesazhit të përcjellë është shumë tronditëse. Fakti që kjo video në të vërtetë ka kaluar nëpërmjet kanaleve të pafund të kontrollit e bën jashtëzakonisht zhgënjyese aspiratën për të punuar me administratën e BE-së.

BalkanInsight, mars 2012

Kosova: reflektime të natyrshme mbi futnotën



Marrëveshja midis Kosovës dhe Beogradit, e arritur me ndërmjetësimin e BE-së, i mundëson Kosovës të përfaqësohet në samite rajonale dhe të nënshkruajë marrëveshje tregtare me vendet e treta. Me të vetmin kusht që emri të shënohet nga një asteriks që e lidh atë me një futnotë.

Ekonomitë e ballkanit duke qenë të vogla rrezikojnë të mos zhvillohen nëse nuk janë të hapura dhe të integruara mes tyre. Sidomos një ekonomi si ajo e Kosovës me më pak se 2 milion banorë. Kosova mund të tërheqë investime nëse produktet e saj kanë hyrje të lirë në tregun rajonal dhe nëse vendi bëhet pjesë e zinxhirëve rajonalë të prodhimit. Kjo marrëveshje siguron pjesëmarrjen e Kosovës në tregun rajonal dhe bashkëpunimet ekonomike. Futnota lë akoma hapur problemet kryesore si mos njohja nga Serbia, Rusia dhe 5 shtete anëtare të BE-së, çështja e veriut, etj. Kjo marrëveshje duhet parë në këtë mënyrë: nëse futnota është zgjidhja, atëherë problemi i zgjidhur nuk është shumë i rëndësishëm.

E rëndësishme është që Kosova mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi rajonal. Për shembull, zhvillimi i CEFTA-s dhe nënshkrimi i një marrëveshje transporti, e bllokuar tashmë që nga viti 2008 për shkak të statusit të Kosovës, tani mund të shkojë përpara, për të mirën e gjithë rajonit. Futnota është element që përdorej edhe më parë nga BE-ja. Vitin e kaluar Britania e Madhe bllokoi rinovimin e regjimit të favorshëm tregtar dhënë nga BE-ja për Ballkanin, sepse Londra insistoi që Kosova të quhet vetëm "Kosovë", pa futnotën. Diskutimet që përfunduan me rrëzimin e kërkesës paraqitur nga Londra, zgjatën një vit, mjaftueshëm që eksportuesit kosovarë të humbnin tregjet dhe konsumatorët duke qenë se produktet e tyre ishin subjekt i detyrimeve të importit dhe kuotave. Problemi i Kosovës është ekzistenca e vazhdueshme e Rezolutës 1244, jo fakti se ajo është përmendur në futnotë.

Osservatorio Balcani e Caucaso, mars 2012

Gratë e Kosovës duan drejtësi, jo lule



Më 8 mars në Prishtinë, me qindra gra u mbledhën për më shumë se një orë përpara godinës së Qeverisë

së Kosovës, duke kërkuar një qasje pro-aktive në bisedimet me Beogradin dhe drejtësi për të gjitha gratë dhe vajzat e përdhunuara gjatë konfliktit, në vitin 1999.

Drejtoresha e Rrjetit të Grave Kosovare dhe organizuesja e protestës, Igballa Rogova, tha se gratë e rënë pre e torturave janë izoluar nga neglizhenca e autoriteteve të Prishtinë dhe Beogradit.

Human Rights Watch ka zbuluar se përdhunimet u përdorën nga ushtria jugosllave si armë lufte dhe instrument për të terrorizuar popullsinë civile, në konfliktin e 1998-1999. Protestueset të cilat preferuan të demonstrojnë më tepër se, siç thanë ato, të marrin lule në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, mbanin parulla me mesazhe të tilla si "Serbia duhet të kërkojë falje për krimet e kryera në Kosovë" dhe "Ne nuk duam lule, duam drejtësi për gratë e përdhunuara gjatë luftës".

"Në vend të kompensimeve për dëmet e luftës, qeveria duhet të kishte kërkuar drejtësi për gratë e përdhunuara" tha Rogova, duke shtuar se Kryeministri Thaçi, përmes marrëveshjes së menaxhimit të integruar të kufirit, ka hapur kufijtë e Kosovës "për kthimin e përdhunuesve tanë".

Stafi i Eurospeak, mars 2012

Të qenit të drejtë me Turqinë është në interes të BE-së

Turqia është i vetmi vend kandidat i BE-së që nuk gëzon nga lëvizja pa viza. Ndërsa turqit shohin serbët, shqiptarët dhe boshnjakët të udhëtojnë në BE pa viza, BE-ja ka refuzuar t'u ofrojë atyre perspektivën e një procesi të liberalizimit të vizave.

Grupet e punës së BE-së shpesh injorojnë që, për sa i përket çështjes së vizave, qytetarët turq tashmë

kanë të drejta ligjore brenda BE-së. Në fakt, këto të drejta tashmë janë mbështetur nga Gjykata e Europiane e Drejtësisë, si dhe nga mjaft gjykata kombëtare, ndër to Gjermane dhe Holandeze.

Ndërkohë që bazat juridike e bëjnë politikën e BE-së për heqjen e vizave të paqëndrueshme, interesat e sigurisë së BE-së e bëjnë atë dhe të paarsyeshme. Aktualisht, BE-ja ka nevojë për mbështetjen e plotë të Turqisë për zgjidhjen e një sërë problemesh të zonës Schengen. Çështja më e rëndësishme mbetet sigurimi i kufirit Greko – Turk. Vitin e kaluar, më shumë se 61 000 emigrantë ilegalë janë zbuluar në këtë vijë kufitare. Duke u lënë të pazgjidhura, valët e emigracionit shumë shpejt mund të vënë në rrezik të ardhmen e Greqisë në zonën Schengen. Pranimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në Schengen mund të shërbejë si një tjetër rrugë shpërthimi për këto dyndje emigrantësh, meqë të dy vendet janë fqinje të Turqisë. Shumica e emigrantëve që kalojnë në Greqi janë algjerianë, afganë dhe somalezë, por jo turq. Zyrtarët turq bënë të qartë se bashkëpunimi me autoritetet kufitare europiane për sigurimin e kufijve kërkon trajtim të drejtë nga BE-ja për sa i përket çështjes së vizave.

Rritja e bashkëpunimit me Turqinë do të ndihmojë Greqinë të rrijë në Schengen dhe do të përshejtojë anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë pa vonesa të mëtejshme. Marrëdhëniet BE-Turqi do të përmirësohen dhe liberalizimi i vizave me Turqinë do të sjellë shumë avantazhe për qytetarët e vendit. Turistët turq, mund të jenë shtysë pozitive për ekonominë europiane, sidomos për Greqinë.

European Stability Initiative, mars 2012

Islanda konsideron dollarin kanadez në vend të euros



Kryeministrja e Islandës, Johanna Siguardardottir, ka thënë se vendi përballet me zgjedhjen midis dollarit kanadez dhe euros. "Zgjedhja është mes dorëzimit të sovranitetit të politikës monetare të Islandës duke adoptuar në mënyrë të njëanshme monedhën e një vendi tjetër, ose duke u bërë anëtarë të BE-së" - ka deklaruar ajo.



Islanda pritet të mbajë një referendum mbi anëtarësimin në BE në fillim të vitit të ardhshëm, por kriza e euros ka tronditur besimin se BE-ja mund të jetë një strehë e sigurt ekonomike. Për partinë opozitare që fillimisht hodhi idenë verën e kaluar, dollari kanadez mund të jetë më tërheqës sesa monedha e përbashkët. Sondazhet tregojnë se 7 nga 10 islandezë duan të heqin koronën, monedhën aktuale të vendit. Por popullsia është e ndarë midis euros dhe dollarit kanadez. Sondazhet gjithashtu tregojnë se vetëm 26 % dëshirojnë të anëtarësohen në BE.

Kriza bankare e vitit 2008 paralizoi ekonominë e Islandës dhe e detyroi atë të marrë hua 7.5 miliardë euro nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe huadhënës të tjerë. Kriza zhduki kursimet dhe pensionet e qytetarëve. Në fillim të marsit, ish-kryeministri i Islandës, Geir Haarde, u hodh në gjyq për “pakujdesi” në kolapsin bankar.

Stafi i EuroSpeak, mars 2012



Bashkimi European një hap më pranë kuotave të grave në bordet e firmave private

Viviane Reding, Komisionere për Drejtësinë thotë që nuk i pëlqejnë kuotat për gratë, por i pëlqen rezultati që ato sjellin. Një vit më parë, ajo ftoi firmat të nënshkruanin një zotim për të rritur përqindjen e grave në bordet e tyre në 30 % deri në vitin 2015 dhe në 40 % deri në vitin 2020. “Nëse nuk do të ketë progres domethënës brenda një viti” - tha ajo në atë kohë - “mund të mbështeteni në krijimtarinë time regullatore.” Deri më tani vetëm 24 firma kanë nënshkruar.

E kështu, në 5 mars Reding njoftoi fillimin e një konsultimi publik tre mujor mbi llojin e masave që duhet të ndërmarrë BE-ja për të nxitur përfshirjen e më shumë grave në bordet e firmave. Kuotat ende nuk përmenden shprehimisht, por dokumenti i konsultimit duket se po hap rrugën për to. Shumë hulumtime tregojnë se kompanitë me më shumë

gra në poste drejtuese janë më të suksesshme se ato pa to (edhe pse nuk ka dëshmi të një lidhjeje shkakësore). Pra, duket se ka kuptim të merren më shumë gra në borde. Por si?

Norvegjia, e cila nuk është anëtare e BE-së, nisi të aplikonte kuotat për gratë në bordet e firmave një dekadë më parë, çka bëri që përfaqësimi i tyre të kalonte nga 9 % në vitin 2003 në 40 % aktualisht. Disa vende të BE-së kanë ndjekur kohët e fundit këtë shembull. Legjislacioni francez prej një viti parashikon që kompanitë e mëdha duhet t’u rezervojnë grave të paktën 20 % të karrigeve të bordit deri në vitin 2014. Deri në vitin 2017 kjo shifër duhet të arrijë 40 %. Që nga hyrja në fuqi e legjislacionit, numri i grave në bordet e firmave franceze ka kaluar nga 12 % deri në 22 %. Spanja dhe Holanda kanë futur ligje të reja, por pa dënime të ashpra. Në Gjermani kuotat mbeten një çështje e debatuar. Popullsia e Europës në përgjithësi duket se është pro rritjes së përfaqësimit të grave. Një sondazh i Eurobarometer publikuar në fillim të marsit, tregon se tre të katërtat e të anketuarve janë në favor të ligjeve për të siguruar ekuilibër gjinor në bordet e firmave.

Bizneset në përgjithësi i kundërshtojnë kuotat, nga frika se ato do ta bëjnë të vështirë emërimin e profesionistëve më të mirë. Ndoshta ajo që nevojitet në të vërtetë është ndryshimi i mentalitetit në çdo nivel për sa i takon qasjes kundrejt fuqisë punëtore dhe karrierës.

The Economist, 10 mars 2012

Ku është më mirë të jesh grua? Vendet që ofrojnë më shumë mundësi ekonomike

Gati gjysma e grave në moshë pune në botë nuk janë aktualisht aktive në tregun formal të punës. Ndërkohë që qeveritë kërkojnë të ringjallin ekonominë e sëmura, përfshirja e këtyre 1,5 miliardë grave në punësimin formal do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Economist Intelligence Unit ka sjellë së bashku 29 tregues si aksesit në financa, arsim dhe trajnim, statusi ligjor dhe social dhe mjedisin e përgjithshëm të biznesit për të identifikuar vendet ku është më mirë të jesh grua. Siç është e pritshme, lista kryesohet nga vende si Suedia, Norvegjia, Finlanda dhe Belgjika. Vende si Australia, Gjermania, Franca, Britania dhe SHBA renditen më poshtë.

Economist, Graphic Detail, 8 mars 2012



Dëftesa e Progresit të Shqipërisë Drejt Anëtarësimit në Bashkimin European Gjatë Vitit 2011



Sipas Vlerësimeve të Progresit Raportit të Komisionit European

Për të nxitur një debat sa më të informuar mbi stadin e reformave të integrimit, EMA po zbaton projektin "Shtjellimi i Procesit të Integrimit European". Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Shqipëri. Në kuadër të

këtij projekti, publikohet Dëftesa mbi Progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE. Ajo merr si pikënisje gjendjen e përshkruar në Raportin Analitik të vitit 2010 dhe pasqyron zhvillimin gjatë një viti, kristalizuar në Raportin e Progresit të tetorit 2011. Ajo synon të shfaqë në një gjuhë më të lexueshme tre kapitujt e tij: 1) Kriterin politik; 2) Kriterin ekonomik; 3) Aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Dëftesa paraqet një vlerësim për çdo nënçështje të secilit kapitull, duke ofruar dhe një krahasim mes situatës së analizuar në Opinionin dhe Raportin Analitik të Komisionit European të vitit 2010 dhe Raportit të Progresit të vitit 2011. Dëftesa vendos gjithashtu në fokus Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), si dokumenti më i rëndësishëm kontraktual midis Bashkimit European dhe Shqipërisë.

Vlerësimi përfshin një shtjellim konciz të progresit gjatë vitit 2011 në secilën fushë, si dhe një vlerësim me notë (ku A është nota më e lartë dhe F më e ulëta). Vlerësimi merr parasysh terminologjinë e përdorur në çdo rast në dokumentet e Komisionit European ("mungon progresi", "progres i pamjaftueshëm", "progres i kufizuar", "progres i pjesshëm", "njëfarë progresi", "progres"), shpeshhtësinë me të cilën ajo është përdorur kombinuar me rëndësinë e çështjes (për shembull, nismat e reja ligjore apo strategjitë përgjithësisht janë vlerësuar më të rëndësishme se trajnimet rutinë apo përmirësimet modeste në kapacitete). Metodologjia e aplikuar nga EMA përbën një fotografim të disa përbërësve që formësojnë një nënfushë, fushë e më pas kapitull.

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integrimit european. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integrimit european. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integrimit european. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integrimit european të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integrimit european; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Ndonëse pranohet gjerësisht se integrimi në BE është një prioritet kombëtar, opinioni publik ende mbetet përgjithësisht i painformuar. Kjo situatë shqetësuese mund të shpjegohet jo vetëm nga kompleksiteti i procesit, por edhe nga fakti që shpesh informacioni dhe analiza mbi BE-në nuk ofrohet nga ekspertët, por jepet kryesisht nga politika. Për të nxitur një debat sa më të informuar mbi stadin e reformave të integrimit në Shqipëri, EMA po zbaton projektin "Shtjellimi i Procesit të Integrimit European", mbështetur nga Ambasada Britanike në Shqipëri.

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri.

Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletinin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: info@em-al.org.

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren,

Blerta Hoxha, në adresën: blerta.hoxha@em-al.org



British Embassy
Tirana

Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e
Ambasadës Britanike në Shqipëri

